



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

NNP "TONI"
Obiliq

MEMORANDUMI BASHKËPUNIMI

Neni 1

Palët nënshkruese të këtij memorandumi:

3. Kolegji BIZNESI- Prishtinë, rruga "Motrat Qiriazi" nr 29 të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi -Dekan, dhe
4. NNP "TONI" – Obiliq me NRB 70162430

Neni 2

Qëllimi i këtij Memorandumi

Ky Memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Kolegji BIZNESI- Prishtinë dhe NNP "TONI" – Obiliq, pajtohen për bashkëpunim.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

4. NNP "TONI" – Obiliq do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi Kolegjin Biznesi, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, të bazuar në politikat e këtij institucionit.
5. Kolegji Biznesi do të mbështesë në vazhdimësi NNP "TONI" – Obiliq në aspektin e mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparaturat për shuarjen e zjarrit si dhe për ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit të saj, me programet e saj arsimore në të gjitha nivelet.
6. Kolegji Biznesi do të mbështesë NNP "TONI" – Obiliq me stafin e sajë akademik, për ligjërata nga lëmia: emergjencave, ekonomis dhe jurispodencës-sipas nevojave që paraqet NNP "TONI" – Obiliq

Neni 4

Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

3. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.

4. Afati i këti memorandumi është në kohë të pacaktuar. Ndryshimet dhe plotësimet e këti Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkuara nga të dyja palët.

Neni 5
Kopjet e Memorandumit

Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.


Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.



PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji BIZNESI Prishtinë

Dekani


/Prof. Dr. Shyqer Kabashi/

NNP "TONI" – Obiliq

Nënshkruar në Prishtinë, me datë 15/01/2018